



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:136911

Datë: 03.10.2024

Numri i dokumentit: 06248084

**2024:136912**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykuese Fitore Daci me bashkëpunëtoren profesionale Lavdije Brahimi-Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurve N.A me vendbanim në rrugën “....” – rrugica ....., Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së dhe A.S me vendbanim në rrugën “.....” në Ferizaj për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II.Nr.201/24, të datës 14.05.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurve N.A dhe A.S, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 23.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **I pandehuri:**

**N.A**, i lindur më ..... në Ferizaj, me vendbanim në rrugën “....”, Komuna Ferizaj nga i ati K..... dhe nëna H....., e gjinisë Ç....., me numër personal ....., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **I pandehuri:**

A.S, i lindur më ....., me vendbanim në rrugën “.....”, Komuna Ferizaj, nga i ati M..... dhe nëna T..... e gjinisë S....., me numër personal ....., i martuar, ka të kryer shkollën e fillore, i gjendjes së dobët ekonomik, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **JANË FAJTORË**

### **Sepse:**

#### **I pandehuri N.A**

-Me datë 10.01.2024, rreth orës 17:20, në rrugën “...”, në Ferizaj, përkatësisht në marketin “.....”, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që hyn brenda marketit në fjalë dhe merr dy herë nga 1 pako me rreth 20 copë çokollata të llojit “*Milka*”, dhe më pas ikë me vrap pa i paguar gjësendet e marra dhe të cilat më pas ia kishte shitur të pandehurit A.S në marketin e tij “.....” në Ferizaj, me ç’rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm pasuror në vlerë prej 50 Euro,-

**-Me këtë veprim ka kryer veprën penale, Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

#### **I pandehuri A.S**

Me datë 10.01.2024, në rrugën “...”, në Ferizaj, përkatësisht në marketin “.....”, i pandehuri me qëllim blen sende për të cilat ka mundur të dijë se janë përfituar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes, në atë mënyrë që ka blerë nga i pandehuri N.A, disa çokollata të markës “*Milka*”, me çmim prej 0.50 € për copë, të cilat ishin gjësende të përfituara me kryerjen e veprës penale sipas përshkrimit si në pikën I të dispozitivit të kësaj aktakuze.

**-Me këtë veprim ka kryer veprën penale, Blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 333 paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, dhe neneve 313 paragrafi 1 dhe nenit 333 paragrafi 2 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 462, të KPPK-së, të pandehurit i:

## **G J Y K O N**

### **Të pandehurin N.A**

**Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve**, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

**Dënim me gjobë në shumën prej 200 € (dyqind euro)**, të cilin dënim është i obliguar të e paguaj në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pasi që Aktgjykimi të e merr formën e prerë.

### **Të pandehurit A.S i shqipton:**

## **VËREJTJE GJYQËSORE**

I pandehuri A.S u njoftua se vepra e tillë përbën vepër penale, vepër e dëmshme dhe e rrezikshme, si dhe nëse i njëjti prapë kryen vepër të tillë, gjykata do t'i shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

E dëmtuara Market..... në rrugën "...", në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të pandehurit që secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga 20 € (njëzetë euro), si dhe të paguajnë shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro), në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data kur Aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

## **A r s y e t i m i**

## **Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP/II.Nr.201/24, e datës 14.05.2024, ka ngarkuar të pandehurit N.A për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së dhe A.S për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 23.09.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurit N.A dhe A.S.

## **Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar**

Në shqyrtimin fillestar të datës 23.09.2024 pasi që gjykata i ka udhëzuar të pandehurit në kuptim të nenit 241 paragrafi 1, të KPPK-së dhe pasi që të pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Pasi që gjykata është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 241 paragrafi 4, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

I pandehuri N.A., me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka theksuar se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza, është penduar thellë, kërkon falje publike, është i gjendjes së dobët ekonomike, premtan se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale si dhe e lutë gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

I pandehuri A.S. me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka theksuar se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza, kërkon falje publike, është penduar thellë, është i gjendjes së dobët ekonomike, premtan se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale si dhe e lutë gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurave, Gjyqtaria e vetme gjykuese në kuptim të nenit 242 paragrafi 5, të KPPK-së, ka kërkuar që Prokurori i Shtetit të jap mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurave, ngase ky pranim i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 242, të KPRK-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, prandaj gjykatës i propozon që këtë pranim fajësie të e aprovoj.

Pasi që të pandehurit kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 paragrafi 6, të KPPK-së, edhe përkundër paralajmërimit të të pandehurave për nenin 246 paragrafi 1, të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se të pandehurat ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si: Raporti fillestar i incidentit 2024-CF-.....; Raporti i policit hetues i dt.08.02.2024; Raporti i oficerit i dt.10.01.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje i të dëmtuarës L.H i dt.16.01.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit N.A, i dt.16.01.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit A.S, i dt.06.02.2024; Ekstrakti mbi dënimet penale i dt.02.05.2024, si dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës dhe konstaton se Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me qenë se të pandehurit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkuara më lartë, andaj Gjyqtaria e vetme gjykuese konform nenit 242 paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

### **Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurve**

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit N.A ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe se në veprimet e të pandehurit A.S ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 2 të KPRK-së.

### **Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, të KPRK-së, dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurin N.A, i mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori parasysh faktin se i pandehuri është penduar për veprën e kryer penale dhe ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsëris.

Po ashtu sa i përket të pandehurit A.S me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, të KPRK-së, dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurin A.S, i mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori parasysh faktin se e pandehuri është penduar për veprën e kryer penale dhe ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsëris.

Ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese dhe të pandehurave i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

### **Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale**

E dëmtuara Market .....në rrugën “...”, në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1, lidhur me nenin 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6, të KPPRK-së.

Vendimin për shumën për Fondin e Kompensimit të viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit 08/L-109.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**2024:136912, datë 25.09.2024**

**Bashkëpunëtore Profesionale**

**Lavdiye Brahimi-Aliu**

**Gjyqtarja**

**Fitore Daci**

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.